



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Durrës më, 03.10.2024

Shtojcë
Njësia e Prokurimit:

Bazuar në nenin 75 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenit 24 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës, vendos të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce:

Shtojcë për një ndryshim të dokumenteve të tenderit, në procedurën e prokurimit me objekt: “Hartimi i planeve të gadishmërisë së emergjencave të digave, hartimi i pashaportave të digave dhe hartimi i projekt preventivave për rehabilitimin e digave”, Nr. REF-22169-09-30-2024, publikuar për zhvillimin e tenderit datë 16.10.2024, ora 10:00. duke iu referuar konstatimeve të grupit të punës i ngritur për hartimin e specifikimeve për procedurën e prokurimit me objektin e mësipërm, vënë në dijeni nëpërmjet email-it zyrtar të njësisë së prokurimit publik më datë 02.10.2024. (email-i do të printohet dhe do t’i bashkëlidhet shtojcës).

Sa më lartë, ndryshimet bëhen në shtojcën 9, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” tek “Kapaciteti teknik dhe profesional” në Sistemit Elektronik të Prokurimit (në vijim SPE) dhe do të jenë si më poshtë vijon:

Ishte:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensë profesionale për Projektim, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, (sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi) për këto kategori:

4. PROJEKTUES INSTALATOR

- c) Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale;
- d) Projektim të sistemeve komplekse të telekomunikacionit;
- f) Projektim të sistemeve kundra zjarrit.;
- g) Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa;
- i) Projektimi i ndricimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndricimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve, etj.;
- j) Projektim të rrjeteve të telefonise, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile dhe industriale.

Ndryshimet e mesiperme ne piken 2.3.1 duhet te behen per shkak se pika 4d) Projektim të sistemeve komplekse të telekomunikacionit; ne sqarim dhe termat e references i eshte kerkuar per rrjetin e internetit , i cili eshte ngatruar dhe mund te projektohet nga pika 4j) Projektim të rrjeteve të telefonise, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile dhe industriale.

Behet:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensë profesionale për Projektim, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, (sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi) për këto kategori:

4. PROJEKTUES INSTALATOR

- c) Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale;
- f) Projektim të sistemeve kundra zjarrit.;
- g) Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa;
- i) Projektimi i ndricimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndricimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve, etj.;
- j) Projektim të rrjeteve të telefonise, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile dhe industriale.

ishte:

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet te ketë si drejtues teknik stafin si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Gjeofizik /Sizmiolog;	Kualifikimet dhe aftësitë <ul style="list-style-type: none">- Diplomë universitare në Inxhinieri Gjeofizik /Sizmiolog- Liçencë personale në projektim Përvojë e përgjithshme profesionale <ul style="list-style-type: none">- Të paktën 10 vjet përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e infrastrukturës kulluese dhe vaditëse. Detyrat: <ul style="list-style-type: none">- Ai/ajo do të jetë përgjegjës për studimin sizmologjike te trojeve
--	--

Ndryshimet e mesiperme ne piken 2.3.2 duhet te behen per shkak se Inxhinier Gjeofizik /Sizmiolog nuk disponon licence individuale sipas VENDIM Nr. 759, datë 12.11.2014, por shoqeria merr licence ne emer te saj me disponimin e inxhinierit Gjeofizik /Sizmiolog per pikat 12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE (vetëm për shoqëri/persona juridikë).

Behet:

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet te ketë si drejtues teknik stafin si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Gjeofizik /Sizmiolog;	Kualifikimet dhe aftësitë - Diplomë universitare në Inxhinieri Gjeofizik /Sizmiolog Përvojë e përgjithshme profesionale - Të paktën 10 vjet përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e infrastrukturës kulluese dhe vaditëse. Detyrat: - Ai/ajo do të jetë përgjegjës për studimin sizmologjike te trojeve
--	---

Data e zhvillimit të tenderit nuk do të ketë ndryshim, do të vazhdojë jetë më datë 16.10.2024, ora 10.00.

Njësia Prokurimit